

ARIAN LEKA

**DOSJA 806 DHE PROCESVERBALI 6/VII/56 NË ARKIVIN E IGJL
DHE LIDHJA E SAJ ME REALIZMIN SOCIALIST**

Hyrje

Përveç teksteve që janë botuar në formë monografish, artikujsh të veçantë apo përmbledhjet e tyre në libra teorikë e doracakë si edhe sprovat për sistemimin e një Historie të Letërsisë shqipe (shqiptare), përveç referateve të publikuar në shtypin letrar e politik të kohës e përtej veprave autoriale, shkruar fillimisht si imitim mimetik i realitetit e më pas nën frymëzimin apo orientimin e metodës së Realizmit Socialist, vlerë të posaçme për hetimin dhe ndjekjen e procesit të kalimit nga metoda artistike në një shkollë a drejtimin letrar unik, siç ishte ai i Realizmit Socialist në Shqipëri, paraqesin edhe dokumentet arkivore. Mes tyre tërheqin vëmendjen edhe materialet që gjenden në Arkivin e Institutit të Gjuhësisë dhe Letërsisë (ASA).

Mes tyre ka dorëshkrime e daktiloshkrime që trajtojnë çështje e problematika të letërsisë shqiptare të Realizmit Socialist. Kronologjia që ndjekin e mbulojnë këto dokumente është e gjerë. Fillesat u përkasin viteve 1950 e në vijim. Në morinë e tyre disa paraqesin interes të veçantë, pasi trajtojnë çështje të teorisë së realizmit socialist, direktiva mbi këtë letërsi nën dritën e veprave të Stalinit apo disa sprova të hershme për monografi mbi realizmin socialist në letërsinë shqiptare.

Pak detaje të kësaj dosjeje janë marrë në shqyrtim veçmas, për të interpretuar çështje të historishkrimit letrar shqiptar të Realizmit Socialist dhe sidomos rrugën përmes së cilës mbërriti kjo metodë. Në të njëjtin rrafsh qëndrojnë edhe çështjet e tipologjive lidhur periodizimin, procesin letrar, kriteret që u përdorën në hartimin e një maketi a projekti për një histori të letërsisë shqiptare, përfshi këtu edhe vëzhgimin mbi kufizimet që lanë jashtë historiografisë disa nga personalitetet e letërsisë shqiptare të viteve 1930-1940.

Një studim të plotë e të hollësishëm lidhur me karakterin e periudhave letrare si dhe rrethanat e rrjedhojat e sprovave për hartimin e tekstit të “Historisë së letërsisë shqipe” ka sjellë studiuesi Shaban Sinani në veprën “Historia e letërsisë shqipe: çështje të hapura”. Kontribut në këtë fushë kërkimi, duke sjellë fakte e interpretimet mbi çështjen e historishkrimit letrar, kanë sjellë edhe studiuesit Ali Xhiku dhe Eldon Gjika.

Në veprën “Historia e letërsisë shqipe: çështje të hapura” studiuesi Shaban Sinani ndjek rrjedhat që sollën ndryshimin e përfytyrimit tradicional

ndaj historisë së letërsisë, “si një pasuri faktesh, veprash e krijuesish më vete”, për të shkuar drejt procesit letrar, që i dëshmonte më gjerë “zhvillimet konvergjente në jetën shpirtërore të popullit si faktor i fuqisë së identitetit të tij.”¹

Duke iu referuar botimit të vitit 1983 të “Historisë së letërsisë shqipe - që nga fillimet deri te Lufta Antifashiste Nacionalçlirimtare”, autori interpreton faktin e mbështetjes së këtij teksti në maketin e vitit 1976. Aty theksohet se një pjesë e vlerësimeve për vepra dhe tendenca të kësaj letërsie nuk u shkruan për t’u botuar, por për t’u shërbyer institucioneve e redaksive botuese për të marrë vendime.

Përsa i përket Realizmit Socialist, theksohet gjithashtu se, për t’i hapur rrugë vetëdijes kritike të letërsisë së shekullit të 20-të, “Historia e letërsisë shqipe në kuptimin terminologjik të fjalës... u kryqëzua sërish në një mit që s’u realizua, në mitin e njeriut të ri; në përcjellje të të cilit shpërfaqet një shturje e përgjithshme e sistemit, me anarki dhe konfuzion jo vetëm në rrjedhat letrare, por edhe në vetë gjykimin e letërsisë.

Lidhur me çështjen sundimit të qëndrimit politik e klasor mbi “analizën e pozitës në letërsi të letrarëve”, studiuesi Ali Xhiku vëren se në praktikën e studimeve historiko-letrare, ky qëndrim krijoi një tezë pune të kudogjendur. Pavarësisht se në vëmendjen e studimit të tij ka qenë periudha kohore mes viteve 1945-1961, autori interpreton disa fakte, përmes së cilave vërehet se, me gjithë përpjekjet për të përfshirë në historinë letërsisë shqipe edhe krijimtarinë e Fishtës, Konicës apo Koliqit, mendësia e përjashtimit ideologjik sundoi dhe se qëndrimet sociale dhe gjykimet klasore zunë vendin kritereve estetike.²

Tematika e historishkrimit letrar ka qenë vëmendje edhe të studiuesit Eldon Gjika, si për periudhën paraardhëse të romantizmit, të cilin ai e vendos në kuadrin letërsive nacionale, rëndësia e së cilës qëndron më fort te nxitja që dha për një përlindje letrare se sa në natyrën e një epoke të thjeshtë të shkrimtarisë”, ashtu për periudhën e realizmit socialist³.

Nën këtë prirje punimi ynë qëmton edhe materiale të tjerë me vlerë dokumentare, të tilla si recension mbi *Historisë së letërsisë shqipe të periudhës 1912-1944*, me autor Nasho Jorgaqin, recension mbi *Historisë së letërsisë shqipe, vol. II*, me autor Ali Xhikun, *Letërsia shqipe e realizmit socialist* si dhe

¹ Shih më hollësisht Sh. Sinani, *Historia e letërsisë shqipe: çështje të hapura*, “Naimi”, Tiranë, 2015.

² Shih më hollësisht A. Xhiku, *Histori e letërsisë shqipe apo histori e letërsisë shqiptare*, revista “Perla”, Tiranë, 2009, Nr. 2. Shih gjithashtu edhe tekste të tjera nga sprovat dorëshkrimi i konsultuar i këtij autori “Një pasqyrë e Shqipërisë letrare në vitet 1945-1961”, Tiranë, 2010.

³ Shih E. Gjika, *Veçori të sistemit letrar shqiptar në periudhën e romantizmit*, botuar në revistën “Përpjekja”, Tiranë 2006, Nr. 23 (Identiteti ndryshe) f. 96-102, si edhe *Realizmi socialist në sistemin letrar shqiptar*, “Albas”, Tiranë, 2019.

diskutimet mbi maketin *Historia e letërsisë shqipe*, me autor Lefter Dilon.

Mes morisë së dokumentacionit të shqyrtuar nga kjo dosje, vëmendje të veçantë i është kushtuar analizimit dhe interpretimit të *Historia e letërsisë shqiptare të realizmit socialist* dhe sidomos *Procesverbalit* me diskutime rreth monografisë së Koço Bihikut, mbajtur në korrik të vitit 1956, si pjesë të Dosjes 806.

Në vëmendje të punimit tonë është kjo periudha mes viteve '50 dhe vitet '70, materialet e së cilës gjenden në dosjen e sipërhënuar. Pjesë e këtij dokumentacioni janë gjithashtu edhe punimet e komisioneve të punës për hartimin e *Historisë së Letërsisë*, studime mbi letërsinë shqipe të Realizmit Socialist, vendime, informacione, recensione si dhe *Hyrja* për tekstin e *Historisë së letërsisë shqiptare të realizmit socialist*, përfshi këtu edhe kumtesa e fjalë të mbajtura në veprimtari shkencore mbi problemet e traditës e të novatorizmit në letërsinë e Realizmit Socialist. Materiali ndaj të cilit shprehim interesim të veçantë, si pjesë e dosjes 806, është një tekst i daktilografuar, me 451 faqe që, si kohë shkrimi mban vitin 1978 si dhe *Procesverbali* rreth monografisë së Koço Bihikut mbi temën e Realizmit Socialist.

Materialet ruhen brenda një dosjeje me kapakë të trashë, prej kartoni ngjyrë kafe, mbyllur në të majtë me beze ngjyrë blu. Anët, nga lart dhe nga poshtë, lidhen me lidhëse me ngjyrë në zezë. Përmasat e dosjes janë 330 mm x 240 mm. Në krye të saj lart, në të majtë, me shkrim dore të kuptueshëm qartë, në dy rreshta të ndarë, është shënuar institucioni përgjegjës dhe vendndodhja e këtij materiali arkivor.

Në rreshtin e parë të kapakut të dosjes shënohet: *Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë*. Në rreshtin e dytë shënohet: *Arkivi i dokumentacionit shkencor*. Nën këtë shënohet gjithashtu numri i dosjes. Saktësisht, me laps të zi plumbi shkruhet: *Nr. 806*.

Në mes të hapësirës së kapakut të dosjes gjendet i shkruar titulli. Shënimi është në tri radhë të ndara. Radha e parë: *Historia e letërsisë shqiptare të realizmit*. Radha e dytë: *socialist*. Radha e tretë: *Së bashku me diskutimet dhe vërejtjet*. Në radhën e dytë të titullit gjendet edhe një mbishkrim më i hershëm, por i palexueshëm, gjë që jep të dhënë se titulli ka ndryshuar, është përmirësuar apo është ndrequr ndonjë gabim i mundshëm.

Edhe teksti i titullit është shkruar me boje blu. Në vijim, më zbehtë se sa në titull, lexohet edhe shënimi *Kapituj të ndryshëm*. Nën titullin e dosjes prej tri radhësh lexohen edhe fjalët: *botuar 1978*. Ky shënim, i mëvonshëm me sa duket, është shkruar me laps të kuq. Në fund të kapakut të dosjes gjendet edhe shënimi *përgjithmonë*. Edhe ky shënim është shkruar me boje blu.

Brenda dosjes së madhe me kapakë kartoni gjendet një dosje e dytë, me kapakë kartonçine të butë, gjithashtu ngjyrë kafe, pak më e çelur se dosja e parë, brenda së cilës gjenden të ndara me kapëse nga njëra-tjetra disa materiale të daktilografuara e dorëshkrime.

Përmasat e dosjes së dytë janë 330 mm x 250 mm. Mbi këtë dosje, shkruar me bojë blu, gjenden disa shënime. Teksti është shkruar me dorë dhe përmban informacion mbi brendinë e dosjes. Lart, në krye, majtas gjendet shënimi: *Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë*.

Në mes të dosjes, me numrin një (1) gjendet shënimi i shkruar në dy radhë të ndara. Rreshti i parë: *Lista emërore e kuadrove që japin gjuhë-letërsi*. Rreshti i dytë, si vijim i të parit shënon: *shqipe në shkollat e mesme*. Me numrin dy (2), në një rresht të vetëm e të pandarë, shënohet: *Lista emërore e personave që do t'u dërgohet maketi i letërsisë*. Poshtë këtij shënimi, në të djathtë, gjendet edhe shënimi *Fq.7*.

Përveç teksteve të dorëshkruara me vlerë informacioni, të dyja dosjet nuk përmbajnë elemente të tjerë, të tilla si firma, vula të institucionit apo emra titullarësh, që mund të jenë marrë me hartimin apo me miratimin e dosjeve, siç dhe nuk ndeshen në asnjë formë të shkruar as emrat e atyre që mund të jenë marrë me shfrytëzimin e dosjes.

Shënimi *maketi i letërsisë*, në rubrikën e numër dy të kësaj dosjeje, është në vëmendje të këtij punimi. Fashikulli që paraqet interes për ne përbëhet nga 20 fletë daktilografike A4 me përmasat 210 mm x 290 mm.

Fashikulli veçohet prej të tjerëve me kapse të vogla metalike. Në daktiloshkim ndeshen rrallë ndreqje të llojit drejtshkrimor, që nuk janë në vëmendje të këtij punimi, si edhe pak gjurmë të përpunuesve të tjerë dokumentacionit arkivor.

Çështje të formimit të kodit gjenetik ligjërimit në optikën e dokumentit

Përsa i përket metodës së Realizmit Socialist, fundi i viteve '40, fillimi i viteve '50 dhe vijimi drejt viteve '60 konsiderohen si periudha kur procesi i ushqyerjes së mjedisit artistik shqiptar me lëndë teorike e politike kishte përfunduar. Kjo pasi veç artikujve të botuar prej vitit 1945 në revistën *Bota e re* e pas vitit 1947 në *Literatura Jonë*, në Shqipëri ishin botuar jo thjesht direktiva të partisë⁴ edhe libra teorikë të veçantë e përmbledhje me artikuj të Plehanovit, Aleksandrovit, Vorovskit, Fadajevit, Llunaçaskit, Timofejevit e Gorkit, por edhe e Ehrenburgut⁵.

Më herët, në vitin 1954, në shtypin letrar shqiptar ishin botuar artikuj të Ilija Erenburgut⁶, që nuk pajtoheshin me shabllonizmin, pllakatizmin,

⁴ Shih më hollësisht fjalën e shoqes Nexhmije Hoxha, mbajtur në Konferencën me shkrimtarët dhe punëtorët e artit, botuar në numrin 7 të *Literatura Jonë*, 1949 si dhe fjalën e Bedri Spahiut po aty.

⁵ Shih *Estetika dhe Letërsia*, përmbledhje artikujsh në dy vëllime. N.SH. e Botimeve "Naim Frashëri", Tiranë, 1961, f. 39-227 dhe f. 278-289.

⁶ I. Erenburg, *Puna e shkrimtarit "Nëntori"*, Tiranë, 1954, Nr. 4, f. 120-141.

mungesën e pluralizmit estetik apo edhe me tezat që e identifikonin artin socialist përparimtar me partishmërinë proletare dhe çështjen e tipikes dhe tipizimit në letërsi si çështje politike.

Vitet që i pasuan sollën praktika të reja në lidhje me imponimin e metodës dhe modelet e ndjekura, ndaj dhe ato paraqesin interes të veçantë.

Arkivi i Institutit të Gjuhësisë dhe Letërsisë, si një ndër vatrat ku ruhen dokumente parësore lidhur me argumentin në shqyrtim, sjell përmes dokumenteve debatin e zhvilluar mes viteve '50 mbi pikëpamjet pro e kundër frymës përjashtuese dhe kriterit politik në hartimin e historisë së letërsisë shqiptare.

Qasja ndaj këtyre dokumenteve i vjen në ndihmë qëmtimit të teksteve që iu mohua botimi, teksteve të botuara a të miratuara, si formë e përfunduar e aktit, të cilat vendosen si përballë origjinalit ashtu si edhe kundrejt prekjeve apo ndryshimeve që dokumenti ka pësuar gjatë kalimit nga gjendja fillestare (daktiloshkrim) në gjendjen “tekst publik” (i botuar).

Me vlerë të tillë paraqitet *Procesverbali i Dosjes 806* dhe *Historia e letërsisë shqiptare të realizmit socialist*, viti 1978 që, edhe pse u porosit, nuk u botua, duke mbetur një maket këshillues për katedrat dhe redaksitë. Vendosja e “tekstit publik”, siç e konsiderojmë, përderisa ky ka qarkulluar dhe është ruajtur në arkiv për shfrytëzim, përballë ripunimeve, ndryshimeve, shkurtimeve, plotësimeve apo pasurimeve të mëvonshme, për shkaqe shkencore apo shmangieve për shkak të ndikimeve e rrjedhave të tjera jashtëletrare, të lidhura kryesisht me politikën dhe ideologjinë, krijon vatra të shumta interpretimi.

Dukuria që vëzhgohet së pari në materialet e shqyrtuara është “korruptimi” i dokumentit gjatë kalimit të tij nga gjendja kumtuese/ligjërimore (për sa kohë që kemi të bëjmë me mbajtje të procesverbaleve) në gjendjen shkrimor/tekst i ngulitur (shënime dëshmuere me shkrim) për të mbërritur në fazën e dhënies së vlerës dokumentit ndaj tyre, siç shfaqet i botuar në *Historia e letërsisë shqipe* Vol. I. II të vitit 1959/1960 apo edhe në botimet e mëvonshme të viteve '80⁷.

Ky proces, megjithëse shoqërohet nga ngjashmëria mes teksteve dhe qëndrimeve, duke shfaqur ndërkaq edhe modifikimin e identitetit të tekstit, ka lënë jashtë mospajtimet apo mendimet e ndryshme të hasura gjatë hartimit të një teksti kodifikues, si *Historia e letërsisë shqipe* në të cilën, ndër të tjera trajtohen edhe çështjet e pranisë apo jo të shkrimtarëve të viteve '30-'40 si dhe çështje të emërtimit e cilësimit të “letërsisë së re” që u shkrua gjatë viteve '50 e në vijim.

⁷ Shih *Historia e letërsisë shqiptare*, botuar nga Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë në Tiranë 1983, grup autorësh, nën redaktimin e Dh. S. Shuteriqit.

Në marrëdhënien “fjalë e kumtuar” gjatë ligjërimit në takimet e grupeve të punës që ishin ngarkuar me hartimin *Historisë së letërsisë shqipe* dhe e “fjalë e mbajtur shënim”, akt ky që përfundon me certifikimin e procesverbalit si dokument i shkruar, dallohen po ato humbje që vërehen gjatë kalimit nga vula (origjinali) te shenja që ajo lë mbi dokument.

Vërehet se identiteti i origjinalit është cenuar, siç është prekur edhe njësia e singularitetit të tij, terma këto të shtjelluar gjerësisht nga Jacques Derrida e që dëshmojnë se si kopja jo vetëm i kundërvihet, por kërkon ta asgjësojë origjinalin, për të zënë tekembramja vendin e tij e për t’u shfaqur si origjinali vetëm e vetëm sepse e riprodhon atë dhe i mbivendoset atij⁸.

E njëjta teori e propozuar nga J. Derrida mund të zbatohet edhe në trajtimin e çështjes së realitetit dhe të realizmit të ofruar nga Realizmi Socialist dhe gjithçkaje që, njëlloj si shenja që lë vula mbi një dokument, (ri)prodhohet për t’i zënë vendin kësaj të fundit.

Pasi kopja bashkëjeton paralelisht me origjinalin, subjekti nuk e ka më të lehtë ta bëjë dallimin mes origjinalit dhe gjurmës/shenjë që lë ai. Subjekti quan dhe një për vulë shenjën/gjurmën që vula e vërtetë lë mbi dokument, e cila në vërtetë është kopja e vulës, pra e origjinalit. Po njëlloj fillon të besojë ky subjekt edhe për realitetin dhe riprodhimin e tij përmes letërsisë dhe arteve.

Subjekti beson nuk ekziston realitet tjetër veç atij që letërsia dhe artet e shpallin si të tillë. Ai nuk beson më në realitetin që jeton, por përjeton realitetin e riprodhuar nga artet. Ky është triumf i imazhit-nënprodukt ndaj produktit origjinal. Kopja fillon të marrë të drejtat e origjinalit dhe të legjitimohet si të ishte origjinali vetë. Realiteti i nxitur, realiteti i simuluar, realiteti i pasqyruar, fiton mbi realizmin dhe realitetin.

Prej kësaj, çdo realitet i hamendësuar legjitimohet dhe fiton të drejtën të quhet realitet, pavarësisht se s’është veçse riprodhim i tij i projektuar nga artet të cilat, për ta çuar edhe më tej teorinë, nuk i referohen dhe nuk kanë më nevojë për një origjinal, siç nuk kanë më nevojë as për realitet.

E gjitha kjo teknologji e mungesës apo mospranisë së reales, realitetit por edhe e realizmit në të njëjtën kohë, të çon drejt teorisë së simulacrum-it, nxitjes, simulimit të modeleve e manipulimit të së vërtetës që, njëlloj si nevojat, nuk janë më pjesë dhe prodhim i realitetit, gjë që na shtyn të mendojmë nëse kemi apo jo më nevojë për një realitet, kur atë mund ta shpikim

⁸ Rreth termave “gjurmë”, “shenjë” dhe “vulë” apo konceptet lidhur me “shenjë e mungesës së një pranie”, “dhuratë gjithmonë e munguar” apo e “mungesës së origjinalit” shih Jacques Derrida: *Of Grammatology*, “The Johns Hopkins University Press”, Baltimore, 1997; si edhe *Writing and Difference*, “Routledge Classics”, New York, 2001.

ta virtualizojmë apo ta përmirësojmë, duke e paraqitur ashtu siç na përshtatet apo na pëlqen⁹.

Nga ana tjetër, falë dokumenteve të marra në shqyrtim bëhet e mundur ndjekja e rrjedhave dhe e hapave të bërë drejt hartimit të teksteve alternative apo të një *Historie të Letërsisë shqipe* (apo shqiptare?) në kushtet kur tërësia e parimeve të një metode artistike/letrare paraardhëse nuk ka mundur ende të marrë formën e një drejtimi të vetëm letrar dhe aq më pak të një metode, që ka qëllim jo vetëm ta riprodhojë botën përmes përfytyrimit, por edhe të ndërhyjë në realitet, duke përpjekur ta ndryshojë/përmirësojë/shndërrojë/edukojë shoqërinë me anë të artit deri në krijimin e qytetarëve të përsosur, siç besonte jo vetëm A. Lunaçarski dhe M. Gorki, por edhe Trocki që shprehej se “sovjetikët janë përfaqësuesit më të përsosur të njerëzve.”¹⁰

Paraqitja uniforme e ofruar në Shqipëri, e cila prirej të merrte trajtën e një metode letrare sintetike, njohu disa faza deri në ngulitjen përfundimtare, duke shenjuar ndërkohë e hap pas hapi edhe emra referencialë, si garantë të tipareve të përgjithshme të metodës dhe stilit vetjak të autorëve. Këta do të bëheshin patriarkët vendas të metodës, krijimtaria e të cilëve u kushtëzua një shkallë të lartë prej “shijes dominante”¹¹ dhe shijes së diktuar.

Për ta vendosur në kohë, periudha e parë e kësaj lëvizjeje i përket viteve ’50 të shekullit XX, veçanërisht ajo që zë fill me Kongresin III të Lidhjes së shkrimtarëve (tetor 1949) e që mund të përkufizohet si periudha në të cilën janë cilësuar e shpallur teorikisht dhe terminologjikisht formulimet dhe parimet bazë të “metodës së Realizmit Socialist”.

Nga ana tjetër kjo mund të cilësohet si periudha me prani jo vetëm të veprave model, përkthyer nga gjuhët e huaja në gjuhën shqipe, por edhe e mbërritjes së veprave të para me frymëzim socialist të letërsisë shqiptare, shkruar pra nën parimet kryesore të metodës së Realizmit Socialist.

Tipar i këtyre prurjeve ishte këqytja e realitetit si *realitet social*,¹² paraqitur nga “punëtorët intelektualë” dhe përftuar si “letërsi e fakteve” dhe “literaturë dëshmuese”, shkruar nga “punonjësit e letërsisë e të arteve”¹³, siç do të cilësoheshin rëndom në dokumentet dhe materialet e PPSH, por që si zhanër

⁹ Shih J. Baudrillard, *Selected Writing: Simulacra and Simulations* (Kapitulli 7), f. 166-184; *Consumer Society* (Kapitulli 2), f. 42-56. Stanford University Press, California, 2002.

¹⁰ Shih J. Reed, *Ten Days That Shook the World* (The Collected Works of John Reed). “New York Modern Library”, New York, 1995, f. 633.

¹¹ Shih Sh. Sinani, *Historishkrimi letrar dhe disa dukuri ndërkulturore: Materialet e Konferencës shkencore Historia e Letërsisë Shqipe*, Prishtinë, 2010.

¹² Shih H. Barbusse, *Zola* “Gallimard”, Paris, 1932, f. 284-5, 289-90, 291-3.

¹³ Shih dokumentet e Plenumit të KQ të Partisë së Punës të Shqipërisë “Mbi forcimin e mëtejshëm të punës për edukimin komunist të rinisë dhe mobilizimin e saj për ndërtimin e plotë të shoqërisë socialiste në vendin tonë”, 26 shtator 1961.

afrohej më fort me publicistikën sesa me letërsinë dhe nuk shënojnë arritje cilësore në përdorimin e fjalës me vlerë artistike.

Në këtë fortesë letrare u përfshinë edhe autorë të traditës më të re shkrimore, që e kishin filluar krijimtarinë gjatë viteve '30 të shekullit XX, të tillë si Dhimitër Shuteriqi, Sterjo Spasse apo Nonda Bulka por edhe autorë më të rinj, krijimtaria e të cilëve përkon me “strehimin” e Majakovskit futurist pranë shkrimtarëve të Realizmit Socialist.¹⁴ Është i dallueshëm ndryshimi gjenetik që ndodh brenda teksteve të autorëve të grupimit të parë mes viteve 1945-1950 dhe asaj që kishin shkruar e botuar gjatë fundviteve '30 deri në vitin 1944.

Edhe pse nuk janë ende të përputhura me kodin e Realizmit Socialist, tekstet e këtyre autorëve “fitojnë” disa nga tiparet e metodës, mes të cilave bie në sy kulti i aksionit (veprimi) në rrëfim (edhe kur kemi të bëjmë me poezi a poemë)¹⁵, retorika e një lloj entuziazmi naiv, që nuk i kanë zhveshur as petkat e sentimentalizmit të prozës së viteve '30 dhe as folklorizmin në teknikën e narracionit dhe praktikën narrative në tërësi. Ky klonim solli modifikim të regjistrit ligjërimit që kaloi lehtësisht “nga toni rapsodik, tek ai patetik”, siç e cilëson E.M.Cioran.

Ndryshimi i regjistrit ligjërimit solli si pasojë edhe ndryshime të tjera që prekën stilin dhe zhanret, të cilat, po t'i referohemi gjuhës së përdorur, jo gjithmonë arrin të përcaktosh nëse tekstura e prodhuar nga shkrimtarët e Realizmit Socialist është një tekst realist, fantastik, komik, irreal apo surrealist.

A ruante letërsia e Realizmit Socialist ndonjë prej tipareve të trashëguara nga realizmi vendas apo bashkë me modelin u importua edhe “gjuha e re” e të shprehurit, që fshin kufijtë lokalë, për të theksuan tiparet e përbashkëta të metodës internacionale, si për të kundërshtuar mendimin se ne (edhe shkrimtari) “nuk banojmë në një vend, por në një gjuhë”¹⁶

Ky lloj i veçantë i letërsisë së përmbytur nga stereotipet dhe klishetë stilistikore, megjithëse nuk arriti dot të bëhej një model mëvetësisht vendas, me tematikë, gjuhë, stil e tipare dhe veçori, krijoi një gjendje ekzili: mërgim nga rrjedhat vendase drejt burimeve të kulturës së re, përcjellë përmes një modeli të ri gjuhësor, që transporton tiparet lokale drejt të shprehurit global. Kjo “gjuhë e re”, ky “model i ri gjuhësor” i përcaktoi një identitet të ri, por jo edhe cilësisht më të lartë, letërsisë shqipe të gjysmës së dytë të shekullit XX.

Autorë shqiptarë të viteve 1945-1955, edhe ata që kishin botuar në

¹⁴ *Russian Futurism through Its Manifestos*, 1912-1928: Ed. Anna Lawton, “Cornell University”, Ithaca & London, 1988.

¹⁵ Shih Dh. Shuteriqi, *O Ptoleme* (1945); V. Bala, *Shtigje drite*, (1946); Ll. Siliqi, *Rruga e lumtunis*, (1950); M. Gurakuqi, *Kangë për jetën*, (1951); Dh. Shuteriqi, *Çlirimtarët*, (1952, 1955); S. Spasse, *Ata nuk ishin vetëm*, (1952); N. Bulka, *Në dritën e yllit*, (1952).

¹⁶ E. M. Cioran, *Anathemas and Admirations*, “Arcade Publishing”, New York, 2012, f. 12.

periudhën mes dy luftërave, por edhe ata që botuan për herë të parë pas çlirimit, kishin hedhur disa hapa drejt teleologjisë dhe asaj metode që, më shumë sesa shkatërrimin, asgjësimin apo zhdukjen tërësore të simboleve të trashëguara, synoi përpunimin dhe shndërrimin e tyre, duke i transformuar dhe nxjerrë prej tyre simbolikë dhe domethënie të re. Ndryshimit iu përshtatën kategoritë klasike të estetikës, të cilat u zhvendosën drejt kategorive etike. *E Bukura* bashkohet me *të Mirën*, *të Drejtën* dhe *të Dobishmen* utilitare dhe etike. Bukuria stilistikore humbet terren e bëhet më pak e kërkuar se sa bukuria morale, për t'u vënë aq shumë në shërbim të së nevojshmes për edukim, sa shteti mund të pranojë një vepër të shkruar dobët nga ana stilistike, por nuk mund të pranojë në asnjë mënyrë një vepër ku ka dhe mbrohen pikëpamje reaksionare.¹⁷

Këtë ndryshim konceptual ndaj kategorive estetike, sidomos ndaj *së Bukurës* e ndeshim edhe në një artikull të V.I. Leninin, botuar në *Literatura jonë* në vitin 1947. Lenini e konsideronte ushqimin e popullit me art si një të drejtë të ligjshme, e cila garantohej nga shteti, për të kërkuar të vërtetën dhe të bukurën. Sa herë që në direktivat e PPSH përmendet koncepti “estetikë”, ajo ndeshet pothuajse si “ideoestetikë” apo “estetika jonë revolucionare” dhe përkufizohet si pjesë e “formimit ideoestetik dhe etiko-moral” apo si “një nga ato aspektet themelore të edukimit komunist”. Kur shfaqet veçmas, “estetika”, si koncept apo si term, i adresohet kritikës apo luftës ndaj “estetikës ekzistencialiste si dhe “rrymave letrare” e “shijeve estetike moderniste”, duke e përfshirë estetikën në rrafshin etik, pjesë të formimit ideologjik edhe atëherë kur duket se novatorizmi kërkimet artistike përkrahet nga shteti.¹⁸

Se çfarë përkufizonte ky shtet me estetikë dhe ndjenjë të së bukurës kuptohet qartë nga mendimi i Enver Hoxhës përmes fjalimeve, kur shprehet: “Ndjenja e hollë për të bukurën dhe shija e lartë estetike kanë spikatur kudo, në rapsoditë e mrekullueshme, në kostumet fantastike, në vallet e mahnitshme, e në shkrimet e rilindësve apo në këngët «rebele» e të ndritshme partizane¹⁹.”

Po ashtu, ndryshime në përfaqësim njohën simbolet, mes të tjerëve edhe ylli. Ylli me funksion fetar (Ylli i Betlehemit, Ylli i Davidit, Ylli pranë hënës në botën islame, si përfaqësim i dritës së dijes) iu përshtat një ikonografie të re fetaro-politike (Ylli i Kuq, simboli më i përfaqësues i ideologjisë komuniste dhe simbol i fesë së vepërës).

Vërehet gjithashtu shfrytëzimi më i gjerë i mjeteve gjuhësore me shprehësi hiperbolike, që vunë në lëvizje elemente të madhështores e të mrekullibërës e që, nga bota e pasur e traditës së fabulës përrallore, iu përshtat

¹⁷ E. Hoxha, *Mbi letërsinë dhe artet* (Çdo gjë të bëhet e të ndërtohet për rininë) “8 Nëntori”, Tiranë, 1977, f. 344.

¹⁸ Po aty. *Të thellojmë luftën ideologjike kundër shfaqeve të huaja*, f. 399.

¹⁹ Po aty. *Përhëndetje Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve*, f. 314.

heroit të ri kulturor dhe kontekstin e ri social, ku dinjiteti e humanizmi u barazua me modestinë, siç njeriu i zakonshëm u zëvendësua me njeriun politik.

Po kështu vërehet edhe seleksionimi i një kategorie të veçantë leksiku përzgjedhur jo sipas vendit e rendit të vet të zakonshëm në fjali, por sipas aftësisë së tyre për të bërë sa më shumë përshtypje, për të nxitur pathosin verbal, patetizmin foljor e mbiemëror e optimizmin. Bashkë me këtë prirje vëzhgohet edhe kufizimi i përdorimit të një pjese të leksikut që lidhej me temat e vdekjes, trishtimit, pesimizmit, siç edhe mistifikimi ideologjik i jetës dhe heroizmit, ngritur në lartësinë e një frymëzimi fetar.

Përtej këtyre, sipas logjikës së klasifikimit kategorik, veç shfaqjeve shoqërore, u rivlerësuan edhe dukuritë natyrore, si fenomenet e motit për shembull, duke u veshur atyre tipare të heronjve, ndarë në përfaqësime pozitive dhe negative (përfaqësimi personifikues e simbolik i motit me diell në dallim nga moti me re).

Pjesë e kësaj u bë edhe vlerësimi i simbolikës së ngjyrave sipas katalogut të përfaqësimit ideologjik, ku të mbiçmuara për shumë kohë, deri me mbërritjen e viteve '80, ishin e kuqja, e kaltra, e arta dhe e gjelbërta.

Sidoqoftë, të dhënat e ofruara nga dokumentet e botuara nuk sjellin aq material, sa të hamendësohet se “metoda e Realizmit Socialist” në Shqipëri, i plotëson kushtet dhe parametrat e një shkolle me tipare e veçanti vendase.

Panorama më optimiste për t'i gjetur “fenomenit shqiptar” një territor brenda hartës së atyre letërsive që iu nënshtruan metodës së Realizmit Socialist, mund të mbërrinte deri te mëtimi i përfshirjes në metodën kanonike ndërkombëtare, të zbatuar gjerësisht në vendet lindore ku demokracitë popullore kishin triumfuar, e ndërthurur me elemente lokalë në tematikë, narrativë dhe mjete ligjërimore.

Me gjithë disa fenomene që tërheqin vëmendjen për studim, të tilla si përkimet me disa prirje të vonuara ndaj modernizmit letrar, ardhur pikërisht në saje të dukurisë së vonësive, përfaqësimet e saj kanonike e lënë atë brenda rrjedhave lokale dhe pjesë e masivit të metodës që u zbatua jo vetëm në vende me traditë jo fort të pasur letrare të Lindjes komuniste, por edhe në vende ku tradita letrare ishte e hershme, e konsoliduar, ndjekëse e rrymave dhe fenomeneve dhe e përfaqësuar me emra madhorë, si Çekoslovakia, Polonia apo Gjermania (Lindore) për shembull.

Kjo pasi baza teorike dhe letërsia në gjuhën shqipe që u botua gjatë atyre viteve në Shqipëri, në të vërtetë dhe në pjesën e vet sunduese dhe të përkrahur nga shteti në rolin e mecenatit parapagues, ishin kalkime të modelit sovjetik ose “përkthim emocional” i një realiteti të shënjuar, që tashmë ekzistonte në vartësi të plotë të shenjës krijuese të metodës a shkollës-mëmë të Realizmit Socialist.

Sizma në vend të skizmës ndaj metodës së Realizmit Socialist

Në dokumentet e marra në shqyrtim prej Arkivit të Institutit të Gjuhësisë dhe Letërsisë mund të hulumtohen jo gjurmë të skizmës, si ndarje e fuqishme dhe kundërshtim ndaj metodës së propozuar të Realizmit Socialist në Shqipëri, por shenja të sizmës, të lëkundjeve e të mëdyshjeve për ta pranuar dhe për t'iu bindur asaj pa e vënë në dyshim a diskutim.

As realiteti dhe as konteksti shoqëror e letrar shqiptar i viteve 1945-1955 nuk ofron qëndrime shembullore ndaj Realizmit Socialist apo skizma të gjalla të ndarjes së fortë, siç kishte ndodhur, për shembull, me fjalimin e shkrimtarit Miroslav Krleža në vitin 1952, mbajtur në Kongresin e Tretë të Lidhjes së Shkrimtarëve, ku ai e cilësoi dogmatik e të papranueshëm formën e Realizmit Socialist që zbatohet në Jugosllavi.

Me gjithë këtë, në disa dokumente pranë Arkivit të lartpërmendur, edhe pse në forma jo të fuqishme, vërehen zëra e gjurmë të rezistencës në pranimin lirisht të modelit të Realizmit Socialist, siç dallohen edhe disa luhatje qëndrimesh në marrëdhëniet me trashëgiminë dhe asaj që ofrohej si modelim i ri i realitetit përmes arteve dhe letërsisë. Sesa të re kishte kuptohet lehtë, përfshi aty edhe shmangiet nga modeli i paracaktuar, sidomos ato që ndodhën gjatë periudhës së referuar, kur Realizmi Socialist në Shqipëri përbën ende një model krejtësisht të importuar nga letërsitë “e shoqërive socialiste motra” dhe pa arritjet e veta (ri)produktiviste, siç bëhet e dallueshme edhe përmes katalogut të botimeve mes viteve 1945-1953 si libra më vete apo publikime në revista e periodikë letrarë.

Duke filluar nga vitet '45-'47-'49 dhe '53-'56 të shek. XX, sprovat e para teorike ia lëshojnë pak e nga pak vendin krijimit letrar të autorëve vendas, i cili merr trajta në mesin e viteve '70, kur nga njëra anë modeli plotësohet e kodifikohet me bazë teorike, prej veprave të para të përputhura me metodologjinë krijuese të Realizmit Socialist (poemat e romanet e mesviteve '50-'60).

Tipari që vihet re gjatë kësaj periudhe është sasia. Ngaqë politikat e asaj kohe prireshin të ngulisin bindjen se ndryshimet sasiore dikur sjellin edhe ndryshime cilësore, në dhjetëvjeçarin pas çlirimit e deri në vitin 1955 vërehet shtim i numrit të letrarëve dhe zgjerim i tirazheve të kopjeve të botuara.

Sunduese për këtë periudhë ishin gjinitë e shkurtra letrare, poezia, proza e shkurtër, në formatin e tregimit dhe skicës. Autorët më të njohur të kohës në poezi ishin Lame Kodra, Llazar Siliqi, Aleks Çaçi, Vehbi Bala, Luan Qafëzezi, Mark Gurakuqi, madje edhe Nonda Bulka me vëllimin *Në dritën e yllit* (1952) dhe Ismail Kadare, me vëllimin *Frymëzimet djaloshare* (1954).

Më të rralla ishin veprat dramaturgjike, si *Prefekti*, nga Besim Levonja (1948), *Halili e Hajrija* dhe *Toka jonë*, nga Kolë Jakova (1950, 1955), *Familja e peshkatarit*, nga Sulejman Pitarka (1955) dhe edhe më rrallë romane, si *Çlirimtarët*, nga Dhimitër Shuteriqi (1952, 1955), *Ata nuk ishin vetëm*, nga

Sterjo Spasse (1952), *Përmbysja*, nga Fatmir Gjata (1954), *Udha e Velanit*, Kin Dushi (1955), *Afërdita përsëri në fshat*, nga Sterjo Spasse (1955).

Në vitin 1954 u themelua edhe revista e përmuajshme letrare *Nëntori*, si organ i Lidhjes së Shkrimtarëve të Shqipërisë. Në këtë revistë u botuan gjithashtu edhe tekstet orientuese të teorisë dhe kritikës letrare të autorëve sovjetikë, si Trofimov, mbi “realizmin socialist, metodë krijonjëse” si dhe artikuj të autorëve shqiptarë, mbi çështje të rëndësishme të metodës krijuese të Realizmit Socialist, të tilla si tipizimi në letërsinë shqiptare apo karakterin popullor dhe frymën kombëtare të letërsisë. Gjatë viteve 1960-1961 kjo revistë luajti një rol të veçantë në trajtimin e çështjes së novatorizmit dhe tradicionalizmit në art, problematikën e heroit pozitiv, nevojën e lidhjeve të shkrimtarëve dhe artistëve me Partinë dhe me marksizëm-leninizmin etj. Aty botuan krijimtarinë letrare mjaft shkrimtarë e përkthyes të kohës, por edhe titullarët më të lartë të nomenklaturës politike, si E. Hoxha, R. Alia apo edhe V. I. Lenin etj.

Nga ana tjetër, kjo krijimtari e “mbrojtur” teorikisht fillon të sulmohet nga brenda prej një grupi shkrimtarësh të rinj, “novatorët”, të formuar kryesisht jashtë Shqipërisë, por gjithsesi në Lindjen e sunduar nga ideologjia komuniste.

Në fillim të viteve '60, ata u kundërvihen “tradicionalistëve” me disa forma që formalisht, por jo rastësisht, përkojnë me trajtat e zonave të futurizmit, duke u vetëparaqitur si shfaqja më e vonuar e ndoshta e mbrame e futurizmit gjatë gjysmës së dytë të shekullit XX, në një kohë kur futurizmi kishte fare pak pikëtakime me ideologjinë mbështetëse të metodës së Realizmit Socialist, nëse te pikëtakimet nuk do të rendisim urrejtnen që kjo “tendencë socio-estetike” kishte për të kaluarën dhe pamjaftueshmërinë e së sotmes (socialiste), që duhet të nxitonte drejt së ardhmes (futuriste). Aktet e kësaj kundërvënije jo vetëm stilistikore dhe estetike, siç u paraqit, dëshmohen prej botimit të debateve dhe krijimtarisë letrare në gazetën “Drita” të vitit 1961 në kundërvënien mes “tradicionalistëve” dhe “novatorëve”.

Duke iu rikthyer argumenteve të materialeve arkivore me vlerë dëshmie ndaj gjurmës se kur arriti e si mbërriti dhe a kishte konsensus gjithpërfshirës apo edhe debati ishte i pranishëm kur ishte në pyetje pranimi i metodës dhe prej këtej edhe hartimi i një teksti historik mbi letërsinë, mes dokumenteve të Arkivit të Institutit të Gjuhësisë dhe Letërsisë veçojmë “Dosjen 806”.

Për efekt klasifikimi dhe burimesh të mëtejshme, disa të dhënat përshkruese shtesë të karakterit formal, që i përkasin dosjes dhe dokumenteve të zgjedhura për shqyrtim do të ishin këto: Ballina e dosjes 806, veç numrit mban të shënuar autoritetin e institucionit: “Institut i Gjuhësisë dhe Letërsisë” me nëncilësimet e mëposhtme: Arkivi i dokumentacionit shkencor. Nën të gjendet titulli përmbledhës i dosjes “Historia e letërsisë shqiptare të Realizmit Socialist së bashku me diskutimet dhe vërejtjet.” Pas këtyre të dhënave, në dy anët e dosjes është shënuar: “*Botuar 1987*” (djathtas) shoqëruar nga shënimi

“përgjithmonë” (majtas). Gjithë sa cilësohet në këtë paragraf mes thonjzave i përket dorëshkrimit dhe jo ndonjë etikete apo skede shoqëruese.

Për sa i takon përshkrimin të mëtejshëm të dokumentit në dosje, vërehet se pjesa më e vëllimshme e saj - siç shënohet edhe në titull - i përket versionit daktiloshkrim (bocë) të *Historisë së Letërsisë* së botuar në vitin 1983 e cila, siç është vënë re edhe më herët, nuk është tjetër përveç se një zgjerim, por jo përmirësim i dy vëllimeve të *Historisë së Letërsisë shqipe* botuar nga Universiteti shtetëror i Tiranës, Instituti i historisë dhe i gjuhësisë në vitin 1959.

Pjesa e mbetur e dosjes, gjithashtu daktiloshkrim, ose daktiloshkrim i qepur me autoshkrimin përkatës apo me shënime të tjera po me autoshkrim, rezulton e ndarë në nëndosje fashikujsh, të cilat me sa duket nuk i përkasin materialit të parë si trup ose e shoqërojnë atë, duke i bërë pjesë e shënimit përmbledhës “...sëbashku me diskutimet dhe vërejtjet.”

Kjo pjesë e dosjes Nr. 806 sjell material mbi ndjekjen e gjurmës gjatë përpjekjeve për hartimin e një teksti teorik dhe ilustrues në Historinë e Letërsisë Shqipe (shqiptare) të Realizmit Socialist dhe shndërrimeve të mundshme të tekstit të saj nga versionin maket (bocë) drejt versionin të botuar (botim).

Në morinë e dokumenteve, interes të posaçëm përbëjnë veçanërisht gjashtë syresh, të cilëve në vijim do të paraqiten me numër rendor, duke i trajtuar dhe klasifikuar si skeda referenciale, cilësuar tipologjikisht sipas titujve përkatës, renditur kronologjikisht (aty ku ky kriter është i mundshëm) dhe me cilësim nominativ të autorit (apo të grupit të autorëve, sipas rastit.)

Dokumenti 1

(Loji i dokumentit) PROCES VERBAL

I mbajtur me datën 6/VII/56 në mbledhjen e Komisionit të Historisë së Letërsisë Shqipe për të diskutuar rreth monografisë së sh. Koço Bihikut ‘LETËRSIA SHQIPE E REALIZMIT SOCIALIST’ (Grup autorësh të pranishëm në mbledhjen së cilës i përket PROCES VERBALI dhe renditur sipas së njëjtit rend me dokumentin:

1. A. Kostallari
2. Z. Sako (oponent i monografisë)
3. K. Bihiku (autori i monografisë)
4. M. Domi
5. S. Pollo
6. Dh. Shuteriqi
7. Ll. Siliqi
8. V. Bala
9. M. Gurakuqi
10. I. Uruçi.

Dokumenti 2

(Lloji i dokumentit) RECENSION
Për Historinë e Letërsisë shqipe të periudhës 1912 - 1914
(autor Nasho Jorgaqi, Tiranë, 9 qershor 1965)

Dokumenti 3

Vërejtje mbi tekstin “Historia e letërsisë shqipe v. II
(Ali Xhiku, Tiranë 26 VII 1974)

Dokumenti 4

NGA DISKUTIMET MBI MAKETIN E HISTORISË SË
LETËRSISË SHQIPE
Vërejtje të përgjithshme
(Pa autor dhe pa datë në daktiloshkrim)

Dokumenti 5

Vërejtje lidhur me letërsinë 1912 - 1939
(Pa autor dhe pa datë në daktiloshkrim)

Dokumenti 6

MBI DISKUTIMIN E PERIUdhës 1912 - 1939 TË HISTORISË
SË LETËRSISË SHQIPE
(Redaksia e tekstit të “Historisë së Letërsisë Shqipe.
Pa datë të shënuan në daktiloshkrim)

Materiali i dokumentit me numër 1 dhe ai me numër 4 kanë lidhje me njëri-tjetrin për shkak se shërbejnë si bazë për hartimin e teksteve të historishkrimeve letrare të hartuara më vonë, ashtu siç kanë lidhje me njëri-tjetrin edhe dokumenti me numër 5 me dokumentin me numër 6, dhe këta të dy me dokumentin me numër 2. Veçmas tyre rri dokumenti me numër 3 i cili si i mëvonshëm. Interes më të madh përbën dokumenti me numër 1, i klasifikuar si PROCES VERBAL.

Përkime dhe mospërkime lidhur e modelin dhe metodën e Realizmit Socialist

Duke u nisur thjesht nga cilësimet e titujve, paraprakisht tërheq vëmendjen një fakt. Në pesë prej gjashtë dokumenteve të marra në shqyrtim, titulli i dokumentit cilësohet gjithmonë dhe shprehimisht “LETËRSI SHQIPE.” Prej këtej krijohet përshtypja se autori i monografisë së HISTORISË SË LETËRSISË SHQIPE TË REALIZMIT SOCIALIST apo të sipërcituarit vetë, të ngarkuar me detyrën e oponentit dhe të komisionit vlerësues të tekstit, tanimë e kanë zgjidhur apo kanë rënë në një mendje mbi atë pikë që edhe sot e kësaj dite shfaqet si një nga çështjet më themelore e ndërkaq më të rëndësishme

për sa i përket një historishkrimi letrar: atë të modelit, metodës dhe parimit bazë në hartimin e një Historie të Letërsisë.

Për kronologji, që në krye vihet re se çështjes së përcaktimit të modelit, metodës dhe parimit i qenë “shmangur” me elegancë që më 1941 Namik Ressuli dhe Karl Gurakuqi, të cilët nën kujdesin e Ernest Koliqit botuan në formë studimi letrar tekstin prej dy vëllimesh “*Shkrimtarë shqiptarë*” (Tiranë 1944).

Nisur nga kjo, duke mos dashur të thelloheshin më tej në trajtime metode, kriteresh dhe parimesh të metodologjisë së hartimit të një teksti historiografik, autorët zgjodhën të shpreheshin me gjithëpërfshirje “*shkrimtarë shqiptarë*”, duke i bërë vend në atë sprovë historishkrimi të letërsisë jo vetëm shkrimtarëve shqiptarë me vepra të shkruara në gjuhën shqipe, por edhe shkrimtarëve me kombësi shqiptare që veprat nuk i kishin shkruar në gjuhën shqipe, gjë që gjithsesi, edhe pse jo krejt e pastër si zgjedhje, e pasuroi tekstin tyre me autorë që mund të mbeteshin jashtë historishkrimit për arsyen kriteriale të mosnjësimit të kombësisë së autorit dhe gjuhës së shkrimit të veprës.

Duke ndeshur pra cilësimin LETËRSI SHQIPE (E REALIZMIT SOCIALIST), në vend të LETËRSI SHQIPTARE besojmë më fort se teksti e ka zgjidhur parimisht problemin e modelimit, duke përzgjedhur parimin e gjuhës së shkrimit të tekstit letrar, mbi parimet e tjera, siç mund të ishin në rastin tonë parimi i kombësisë së autorit, territorit prej nga vjen vepra e shkruar në shqip apo ndonjë kriter tjetër që mund të lidhej me shkollat apo estetika të veçanta letrare. Por pikërisht këtu ndeshet thyerja e parë që ngre dy supozime:

E para: në vitin 1956 (koha e hartimit të dokumentit të parë të marrë në shqyrtim prej nesh) me fjalën/cilësorin SHQIP/E kuptohej ajo letërsi që lëvrohej vetëm brenda territorit politik të Shqipërisë(?).

E dyta: Tashmë ishte e sigurt dhe e nënkuptueshme njëkohësisht se jashtë kufijve politikë shtetërore të Shqipërisë, shkrimtarë a publicistë shqiptarë për nga kombësia (të emigruar apo të arratisur për arsye politike si, E. Koliqi, A. Pipa, B. Xhaferri, B. Merxhani, J. Luzaj, T. Zavalani, M. Camaj etj.) nuk shkruanin nën metodën krijuese të Realizmit Socialist.

Kësisoj, vendosja pranë e pranë e togfjalëshave LETËRSI SHQIPE e REALIZMIT SOCIALIST nga njëra anë luante vetiu rolin e antonimeve, për të mos thënë edhe të oksimoroneve, dhe nga ana tjetër dëshmonte shkallën e përjashtimit në shoqërinë shqiptare të letrave, ndarë tashmë për shkak të ideologjisë.

Me “*letërsi shqipe*” quhej vetëm ajo pjesë e letërsisë që cilësohej përparimtare, progresiste, revolucionare, në kundërshtim me atë regresiste, reaksionare, dekadente, duke lënë kësisoj jashtë një pjesë të vyer të trashëgimisë letrare, gjë që do të sillte varfërimin e vlerave të vetë letërsisë së shkruar në gjuhën shqipe.

Në një vështrim prania e përcaktorit LETËRSI SHQIPE dhe moszbatimi a mosshprehja e qartë e kriterit në tekstin e monografisë na tregon qartazi mungesën e qartësisë kriteriale dhe konceptuale në hartimin e një vepre që do të duhej të ishte Historia e Letërsisë (qoftë ky edhe në formë maketi) mbështetur mbi kriteret e një disipline a nëndisipline shkencore. Kaq sa i përket titullimit dhe këqyrjes së dokumentit në anë formale dhe përcaktimit të metodologjisë në të.

Nga ana tjetër dokumenti në vetvete zgjon interes të posaçëm për paraqitjen e pikëpamjeve të anëtarëve të Komisionit në vlerësimin e monografisë para se ajo të bëhej gati për botim, diskutime këto të mbajtura në prani të autorit (sh. K. Bihiku) dhe oponentit të tekstit (sh. Z. Sako).

Mendimet e këtyre anëtarëve përbëjnë interes pasi përfaqësojnë nga njëra anë formimin dhe mendimet e tyre si personalitete dhe funksionarë të lartë në nomenklaturën e artit, kulturës dhe edukimit në vend, dhe nga ana tjetër edhe frymën sunduese të kohës në lidhje me letërsinë dhe procesin krijues.

Në këtë pikë nuk mund të dalim në vlerësime të drejta pa i paralelizuar dhe kryqëzuar këto dokumente arkivore me tekstet e Historisë së Shqipërisë apo thënë më saktë me Historinë e PPSH, prej nga dhe buronin edhe direktivat dhe qëndrimet mbi rolin e artit dhe kulturës.

Lidhur me këtë argument dhe për të kuptuar më mirë vlerën e këtij dokumentit në shqyrtim duhet të shënjojmë edhe një sërë datash që drejtpërdrejt apo tërthorazi lidhen me këtë PROCES VERBAL.

Ndërkaq disa nga ngjarjet kryesore kulturore dhe letrare duke filluar nga vitet '50 lanë gjurmën e vet në letërsinë, kulturën dhe mënyrën e të bërit histori e duke vijuar drejt vitit kur e ndeshëm për herë të parë termin “realizëm socialist” e gjer më 6/VII/’56, kur siç thamë, daton dokumenti që kemi në shqyrtim.

Këto data janë:

1950

- Llazar Siliqi boton vëllimin me poezi *Rruga e lumturis;*
- Dhimitër Shuteriqi, *Letërsia e re shqipe;*

1951

- Fatmir Gjata boton *Ujët fle, hasmi s'fle;*
- Aleks Çaçi boton *Këngët e dheut;*
- Mehmet Myftiu boton *Njerëzit e fabrikës;*
- Mark Ndoja boton *Vjersha dhe poema;*
- Botim i posaçëm i revistës “Literatura Jonë” me rastin e 10-të vjetorit të themelimit të Partisë. Në përmbajtjen e të cilit ndeshim edhe krijimet:
 - Andrea Varfi, *Bir'i Partisë;*
 - Bedri Dedja, *Enver! Parti!;*
 - Llazar Siliqi, *Enverit;*

- Injac Zamputi, *Dritat*;
- Mark Gurakuqi, *Partisë*;
- Mark Ndoja, *Lenin-Stalin*;
- Nonda Bulka, *Partinë mbi të gjitha*;

1952

- Dhimitër Shuteriqi boton vëllimin e parë të romanit *Çlirimtarët* (vëllimi II, Tiranë 1955);
- Sterio Spasse boton romanin *Ata nuk ishin vetëm*;
- Ali Abdihoxha boton *Në malet tona*;

1953

- Mark Gurakuqi, *Pranverë*;

1954

- Themelohet revista *Nëntori*, e përmuajshme letrare e Lidhjes së Shkrimtarëve të Shqipërisë;
- Fatmir Gjata boton romanin *Përmbysja*;
- Fatmir Gjata boton poezitë *Këngët e maleve*;
- Ismail Kadare boton përmbledhjen me poezi *Frymëzime djaloshare*;

1955

- Kin Dushi boton romanin *Udha e Velanit*;
- Sterjo Spasse boton romanin *Afërdita përsëri në fshat*;
- Llazar Siliqi poemën *Mësuesi*;
- Kolë Jakova dramën *Toka jonë*;
- Vehbi Bala boton *Gjaku i falun*;
- Sulejman Pitarka vë në skenë *Familja e peshkatarit*;
- Dhimitër Shuteriqi, *Historia e letërsisë shqipe*;

1956

- Naum Prifti boton *Tregime të fshatit*;
- Loni Papa boton *Fillo këngën çifteli*.

Mes këtyre viteve botohen poezi, poema e balada apo edhe libra të tërë tematikë, që lidheshin ngushtësisht me realitetin dhe që i bënin pasqyronin apo i bënin jehonë ngjarjeve të ditës, shfaqur në krijimtari të tilla si: *Doli nana në çardhak* e Vehbi Balës, *Komisari*, i Zihni Sakos, *Kënga e partizanit Benko* e Fatmir Gjatës, dhe poemat *Biri i Partisë* me autor Andrea Varfin, *Heronjtë e Vigut*, me autor Kolë Jakovën, *Miku* i Llazar Siliqit, *Gjeto plaku* i Mark Gurakuqit.

Disa përpjekje në fushë të studimeve letrare që i shkojnë pranë periudhës në fjalë vijnë nga jashtë Shqipërisë, por që i mbyllin përfundimet e tyre kryesisht me Luftën II Botërore. Vepra të tilla si *Svolgimento storico della*

*cultura e della letteratura albanese*²⁰ shkruar nga Gaetano Petrotta apo *Storia della letteratura albanese*²¹ me autor Giuseppe Schirò, mbajnë në vëmendje letërsinë arbëreshe, por dalluesi i tyre kundrejt teksteve që kishin filluar të botoheshin në Shqipëri në vitet '50 është qëndrimi ndaj autorëve të traditës, sidomos ndaj atyre të viteve '20-'40²². Po të njëjtën panoramë, prirje e qëndrim shfaq edhe studimi me titull *Albanian Literature, an outline of prose, poetry and drama*²³, që mban autorësinë e Stuart Mann-it. Të gjitha këto rrjedha padyshim do të linin gjurmën e tyre dhe këto shfaqen edhe në vërejtjet apo qëndrimet e dokumenteve në shqyrtim.

Është me interes edhe fakti se vërejtja e dalë nga Komisioni për mungesën e një kriteri konsekuent apo ndërthurja e disa kriterëve të volitshëm për hartimin e një historie të letërsisë nuk ka kaluar pa u vënë re nga anëtarët e këtij Komisioni. Lidhur me këto shkruhet: “Kriteri që ka ndjekur autori në hartimin e monogr. e ka damtue ma tepër, sidomos kriteri kronologjik tue u marrë herë me biog. e shkrimtarit e herë me veprën, në vend të shpërndame etj.”²⁴

Argumentit të kërkimit të kriterit, Llazar Siliqi, diskutuesi që renditet në krye të PROCES VERBALIT, i është rikthyer edhe kur propozon kontribute jo individuale “*për hartimin e monografisë të bashkëpunojshin disa autorë*”,²⁵ siç i cilëson ai.

Në vijim Llazar Siliqi vëren gjithashtu se edhe poezia “si gjinia ma e zhvillueme e letërsinë sonë”, “për poezinë e viteve 1950-1955 që asht periodha ma prodhuese e poezisë”, është e pa përfaqësuar sa duhet në tekst, vetëm me 5 faqe.

Fjala e autorit K. Bihiku që nuk gjendet bashkëlidhur me PROCES VERBALIN si dhe oponenca e Z. Sakos do të na ndihmonin për të kuptuar dhe njohur më drejt arsyet e kësaj shmangieje, e cila mund të jetë për arsye të mospëlqimit estetik, mosvëmendjes për shkak të pamjaftueshmërisë së kohës (*dy muej*, shprehimisht në tekst) apo për shkak të mosvlerësimit të zhanrit.

Tjetër vërejtje e Llazar Siliqit që vlen të interpretohet është edhe ajo që lidh kriterin jashtëletrar me vlerësimin e letërsisë sipas opozicioneve *përparimtare-reaktionare* dhe trajtimin e disa personalitetëve letrarë sipas *kritereve ideologjizuese*.

²⁰ *Studi di storia della letteratura albanese (Svolgimento storico della cultura e della letteratura albanese)*, Palermo 1950.

²¹ Giuseppe Schirò, *Storia della Letteratura Albanese*, Milano, 1959.

²² Shih *Historia e letërsisë shqipe*. Vol. I, II. Dhimitër S. Shuteriqi etj. “Universiteti shtetëror i Tiranës, Instituti i historisë dhe i gjuhësisë” Tiranë, 1959/1960.

²³ *Albanian literature: an outline of prose, poetry, and drama*. “B. Quaritch”. London 1955; The University of California 2008.

²⁴ Shih Ll. Siliqi, PROCES VERBALI, f. 1 e dokumentit.

²⁵ *Po aty*, f. 2.

“Ndamja e kampeve në përparimtarë e reaksionare asht artificiale”, shprehet ai për ta vijuar logjikën mbrojtëse, zbutëse a pajtuese me argumente ndaj emra të përveçëm: Duhet përcaktue ma mirë e ma konkretisht. Në lidhje me shprehjet kundrejt Koliqit, Fishtës, L. Skëndos nuk janë fort ekzakte. Duhet dallue ma mirë e ma konkretisht veprat e tyre, nuk mjafton të thuesh se ata kanë ba vepra vetëm fashiste. P.sh. Haxhiademi nuk ka ba vepra fashiste, por ai kritikohet për anakronizëm etj”²⁶, shprehet Ll. Siliqi.

Ky konstatim zgjon interes pasi në vitin 1956 ishte përcaktuar përfundimisht edhe vija dhe qëndrimi zyrtar ndaj shkrimtarëve të sipërpërmendur dhe krijimtarisë së tyre. Nga ana tjetër Ll. Siliqi dëshmon prirjen e disa shkrimtarëve-studiuës për t’i bërë vend, qoftë edhe përmes qëndrimit kritik, këtyre shkrimtarëve të paraluftës, prirje që hasi përherë në refuzim të prerë zyrtar.

Në mbyllje të vërejtjeve të veta Llazar Siliqi shprehet edhe për ndarjen e kriterëve, ndarjen e vlerësimeve letrare prej atyre jashtëletrare, kur bie fjala për hartimin e një monografie. Po aty ai thekson se “duhet të hiqen shprehjet kategorike”, shtron kërkesën “për paraqitje të letërsisë minoritare” dhe shpreh mendimin “të hiqen fjalët fitues i çmimit të Republikës” etj., si kriterë vlerësimi për autorët.

Në vërejtjet mbi monografinë, krahas faktit se tekstit i duhet bërë “një vlerësim shkencor”, Vehbi Bala shpreh edhe qëndrimin e tij se në tekst “mungon jehona e letërsisë sonë jashtë shtetit”. Vërejtja e parë ka të bëjë pikërisht me metodologjinë divulgative, komentare dhe përshkuese të përdorur nga autori, metodë kjo që ia ulte tekstit pretendimin për një vepër mirëfilli shkencore.

Mendimi i dytë shfaqet disi paradoksal, pasi në kohën kur u mbajt ky procesverbal letërsia shqipe nuk kishte zgjidhur ende plotësisht marrëdhëniet lidhur me importimin e modelit (siç do të vërehet edhe nga diskutuesit e tjerë të po këtij PROCES VERBALI), ndërkohë që nga kjo vërejtje pretendimi që po kjo letërsi të eksportojë rimodelimin e saj duket paksa optimist duke marrë parasysh se sa i ulët ishte interesi për t’i përkthyer veprat e reja te letërsisë shqiptare!

Ky argument mund të lidhet drejtpërdrejt me faktin se për vitet në shqyrtim shteti komunist kishte filluar ta projektonte përdorimin letërsisë së re në funksionin e një table emulacioni si përligje të sistemit komunist në fillimit të veta dhe plotshmërisë së Realizmit Socialist.

Dhimitër Shuteriqi në diskutimin e tij i rikthehet tezës së parashtuar nga Ll. Siliqi mbi funksionin estetik të veprës dhe praninë e këtij funksioni edhe në

²⁶ Dokument i cituar, Llazar Siliqi, *po aty*, f. 2.

monografi. “Nuk thuhet asgja për veprën si art. Gjithashtu edhe për gjuhën e autorëve nuk thuhet asnjë fjalë”,²⁷ shton ai në argumentimin e tij.

Ndërkaq, në mënyrë jo fort bindëse po ky vlerësues shprehet në vijim kundër idesë së autorit²⁸ se “letërsia nuk dha ndonjë program... nuk bëri thirrje për luftë kundra fashizmit”. “Si nuk ka? Duhet parë revista Bota e Re etj”., duke vijuar më tej me vërejtjen tjetër që vjen përputhur me tezën zyrtare se në monografi²⁹ “nuk flitet për rolin e influencës së letërsisë sovjetike në letërsinë tonë.”

Në vërejtjet e Dhimitër Shuteriqit, veç mosgjetjes së një pozicioni të drejtë mes estetikës apo ideologjisë, ndihet edhe përdorimi i termave që duket se ishin ngulitur dhe kishin zënë vend, të tilla si “realizëm socialist”, “diktaturë e proletariatit”, “heroi pozitiv”.

Por sapo formohet një qëndrim mbi anësinë e këtij autori pro skemës, Dhimitër Shuteriqi ofron një tjetër argument që tingëllon disi kundërthënës, sidomos kur sapo je ndarë nga termat e lartpërmendur në lidhje me metodën dhe elementët përbërës të Realizmit Socialist.

Edhe një herë në dokument shfaqet prirja e marrjes në mbrojtje të një lloji të veçantë krijimtarie, shprehur në emra të përveçëm përmes krijimtarisë së Nexhat Hakiut, në një kohë kur ky autor dhe krijimtaria e tij ishin dënuar publikisht nga Bedri Spahiu³⁰. “N. Hakiu është përpjekur në jetën e tij letrare për të punuar dhe nuk është e nevojshme të përmendet në H. e L. si përfaqësues i dekadentizmit. Njerëzve që duan të punojnë duhet t’u çelim rrugën dhe jo t’ua mbyllim”,³¹ shprehet Dhimitër Shuteriqi.

Ky qëndrim pro kriterit letrar ndaj atij biografik ndeshet edhe në rastin e Sejfulla Malëshovës, si autor tanimë, për të cilin në tekst shkruhet: “Kritika ndaj S. Malëshovës duhet bërë përmes veprave të tij”,³² duke bërë një përpjekje për veçimin e krijimtarisë letrare nga qëndrimi politik ndaj Malëshovës.

Në vërejtjet e veta Androkli Kostallari i rimerr për trajtim aspektet kriteriale që duhet të ndiqen në hartimin e një teksti të karakterit shkencor. Ai paraqet idenë e hartimit të një monografie të ndërtuar “sipas temës dhe sipas gjinisë”,³³ siç shprehet ai.

²⁷ *Po aty*, f. 3.

²⁸ K. Bihiku, f. 4, cit. i dokumentit.

²⁹ *Po aty*, f. 5 e monografisë, cituar sipas dokumentit.

³⁰ Shih për më gjerë “Literatura jonë” 1950/4, f. 66.

³¹ Dokumenti i cituar, f. 4.

³² *Po aty*.

³³ *Po aty*, f. 5.

Me karakter kriterial është edhe vërejtja tjetër lidhur me periodizimin e letërsisë, kriter që sipas A. Kostallarit “duket si shumë kategorik. Çfarë shënon viti 1950 në Historinë e Letërsisë?”³⁴, pyet ai.

Nga ana tjetër Androkli Kostallari shprehet kritik si ndaj autorit të veprës ashtu edhe ndaj Dhimitër Shuteriqit për mënyrën se si është paraqitur në monografi lindja e metodës krijuese të Realizmit Socialist në Shqipëri. Sipas Kostallarit autori “çështjen e lindjes së Realizmit Socialist e trajton fare pak, duke mbivlerësuar influencën sovjetike”.³⁵

Ky konstatim tërheq vëmendjen pasi përmes tij kundërshtohet teza zyrtare e importimit, kalkimit të metodës dhe mbivlerësimit të rolit të letërsisë sovjetike.

Gjithashtu, një mënyrë e tillë e argumentimit e lë të hapur rrugën e trajtimit të ardhjes së modelit letrar në fjalë jo vetëm si “shkollë” dhe “metodë” e imponuar, por edhe falë përvojave shkrimore që i dha Realizmit Socialist shqiptar prania e realizmit të periudhave letrare paraardhëse. Për çështjen e përmbajtjes Kostallari shpreh rezerva gjithashtu, pasi ana përshkrimore, ritregimi i përmbajtjes së veprave i jep monografisë më shumë vlerën e “një artikulli të gjatë sesa të një studimi”³⁶.

Çështja e përmbajtjes së monografisë përbën interes edhe për Mark Gurakuqin, sipas të cilit karakteri rrëfimtar i ritregimit të përmbajtjes, karakteri recensional si dhe mungesa e një qëndrimi kritik e ka dëmtuar deri në atë pikë sa “kjo monografi në këtë gjendje, jo vetëm që nuk është e botueshme, por nuk shërben as si bazë për Hist. e Letërsisë.”³⁷ Në vijim të arsytimit të tij lidhur me metodologjinë, ai shprehet pro periodizimit si kriter ndërtues një historishkrimi të letërsisë shqipe të Realizmit Socialist dhe ndërkaq kundërshton mendimin e Kostallarit mbi produktin letrar të vitit 1950, duke dhënë këtë argument: “Kjo datë, d.m.th. viti 1950, nuk është kot, si mendon A. Kostallari, por është datë që shënon prodhimin më të madh në letërsinë tonë pothuaj në të gjitha gjinitë.”³⁸

Referuar kronologjisë së datave kryesore të jetës politike dhe kulturore mes viteve 1944 - 1956, paraqitur në faqen 8 të këtij relacioni, rezulton se viti 1950 me përjashtim të veprës së Lllazar Siliqit, *Rruga e lumtunis*, dramës historike të Kolë Jakovës, *Halili e Hajria*, nuk sjell ndonjë vepër letrare me rëndësi të veçantë as për letërsinë shqipe marrë në vështrim të përgjithshëm dhe as për metodën e Realizmit Socialist që ta përligjë thënien e mësipërme të Mark Gurakuqit.

³⁴ *Ibid.*, f. 5.

³⁵ *Ibid.*

³⁶ *Po aty*, f. 6.

³⁷ *Ibid.*

³⁸ *Ibid.*

Veprat që kodifikuan këtë metodë dhe legjitimuan modelin në letërsinë shqipe, me përjashtim të ndonjë sprove në poezi e prozë të shkurtër, i përkasin viteve të mëpasme me romanet *Çlirimtarët* (1952-1955), *Ata nuk ishin vetëm* (1952), *Përmbysja* (1954), *Këneta* (1959), *Para agimit* (1965-1966) etj. Mark Gurakuqi përkrah po ashtu mendimin e Shuteriqit për një trajtim jo të skajshëm që duhet mbajtur ndaj shkrimtarëve dhe përmend rastin e Nexhat Hakiut i cili në monografi përfillet si “përfaqësues i dekadentizmit.”

Por ndërkaq, në po ato radhë, Mark Gurakuqi bën edhe një pohim të dhimbshëm lidhur me trajtimin e diferencuar apo të mbajtjes së një qëndrimi politik dykriterësh dhe përjashtues ndaj shkrimtarëve të ndaluar nga Partia, duke u bërë njëherazi dëshmitar i asaj që ishte thyer në mënyrë të pandreqshme tanimë mes shkrimtarëve shqiptarë - përjashtimi i tjetrit në dy mënyra: rasti Nexhat Hakiu dhe rasti Mitrush Kuteli. “N. Hakiu punon dhe asht riabilitue dhe prandaj nuk mund të futet në një kategori me M. Kutelin”³⁹. Mahir Domi në tekstin e tij propozon periodizimin si kriter, duke e ndarë letërsinë në tri etapa studimi ku duhet të mbizotërojë karakteri panoramik.

Si përfundim PROCES VERBALI i datës 6/VII/1956, veçuar si objekt studimi, përbën një tekst me vlerë dokumentare dhe mundësi interpretuese, duke iu shtuar dokumenteve që hedhin dritë mbi rrugën që ndodhi mbërritja e termit Realizëm Socialist dhe metoda e zbatimit të tij, por edhe mbi disa përpjekje që, edhe pse të pasuksesshme, dëshmojnë se procesi drejt hartimit të veprës me titull LETËRSI SHQIPE (E REALIZMIT SOCIALIST) nuk ka qenë monolit. Ky maket a model paraqet një fazë të hershme, por ndoshta edhe të fundit mes përpjekjeve për ta pasur më të plotë historishkrimin e letrave shqiptare, pak kohë më herët se të nisnin spastrimet ideologjike dhe përjashtimet e estetikave të tjera paraardhëse e pasardhëse, të ndryshme e të kundërta nga ajo e Realizmit Socialist.

Vendosur në kohën e përpilimit të tij, dokumenti dëshmon nga njëra anë gjendjen e letërsisë dhe shkencës teorike letrare shqiptare në atë kohë, përpjekjet për realizimin e një sprove monografike në kushtet e mungesës së përvojës, por dhe kompetencës e kapaciteteve reale për të nisur një ndërmarrje të tillë.

Nga ana tjetër dokumenti i shqyrtuar ofron të dhëna sinoptike mbi klimën sunduese politike, shoqërore e letrare të kësaj periudhe, kur duket qartazi se përpjekja e ideologjisë zyrtare për të sunduar mbi kulturën dhe artet, ndonëse e kudogjendur, paraqet ende disa lëkundje. Kjo përpjekje, së paku deri në çastin të cilit i referohemi, nuk është bërë sunduese dhe e unifikuar, së paku ende jo plotësisht, siç do të dëshmohej gjatë viteve në vijim, ku sistemi i sapothurur njej dhe merr goditje dhe kontestime si nga jashtë, sidomos nga

³⁹ Po ai dokument, f. 7.

Ernest Koliqi dhe Martin Camaj, me shkrimet e tyre kritike botuar në revistën “Shejzat” mes viteve 1957-1967⁴⁰ ashtu edhe nga brenda vetë sistemit.

Por ekzistenca e proceseve spastruese e përndjekëse, që vijoi edhe gjatë periudhave të mëvonshme plotësohet edhe nga pohimet të natyrës “sugjerimet tona nuk u pranuan dhe teksti, që përgatiti Instituti i ASH, u botua me titullin “Historia e letërsisë së realizmit socialist (1944-1988)⁴¹, histori e cila la jashtë vëmendjes pjesën e letërsisë në gjuhën shqipe që shkruhej jashtë kufirit politik të Shqipërisë dhe jashtë kufirit estetik të ndikimit të Realizmit Socialist.

Jashtë vlerësimit mbetën të gjitha orientimet estetike të ndryshme a të kundërta nga drejtimi i Realizmit Socialist të cilat, edhe pse të shkruara “me gjuhën e përbashkët shqipe e me frymë kombëtare”, nuk u bënë pjesë e historisë letrare, me argumentimin se “përfshirja e tyre në një histori të përbashkët kombëtare do të “legalizonte” në përgjithësi pluralizmin estetik të letërsisë dhe nuk do të mbivlerësoheshin krijimet vetëm të letërsisë të “atdheut amë” që, njëlloj si në ekonomi e politikë, kishte gjithashtu në themel “principin e ndërtimit të kulturës me forcat e veta”⁴².

SUMMARY

FILE 806 AND THE RECORD NO 6 / VII / '56 IN THE INSTITUTE OF LINGUISTICS AND LITERATURE ARCHIVE AND ITS CONNECTION WITH SOCIALIST REALISM

The documentation of the '50s, which inserted the Albanian literature in the course of Soc-Realism, besides other things, is presented through archival facts, which are stored in the Archive of the Institute of Linguistics and Literature (Tirana). Among them, some manuscripts draw attention, as they are dealing with issues of directive and political order, which replaced the aesthetic criteria and typologies of historiography with the class affiliation and ideological beliefs of the writers of those times. These documents are part of the 806 File, which contains recordings, valuable annotations, decisions, information and reviews for study, which make understandable the dominant spirit of the time and the opposing voices around it. The materials provide data on model issues in the design of a “Standard model” or a “Monograph” on the

⁴⁰ Për më shumë rreth argumentit shih edhe artikullin e prof. Laura Smaqi me titull *Realizmi socialist në optikën e ‘armiqve’* (kumtesë e mbajtur në Konferencën Shkencore “Letërsia shqiptare dhe realizmi socialist”, Tiranë, 2010).

⁴¹ A. Uçi, *Historishkrimi letrar dhe disa dukuri ndërkulturore: Materialet e Konferencës shkencore Historia e Letërsisë Shqipe*, Prishtinë, 2010, f. 117.

⁴² *Po aty*.

history of Albanian literature, its periodization and literary process. Of particular interest are the documents that contain the criteria that were followed on the admission or exclusion of some personalities of Albanian literature from historiography. Part of it is the formulation for the replacement of aesthetic pluralism with the role and functions that the new literature for the formation of the masses took, turning it into an instrument of “ideo-aesthetic” and “ethical-moral” modelling of political formation. The documents shed light on, not only the path followed by the arrival of the terminology “socialist realism”, but also its methodology of how to reach it. In those documents, some attempts are made to prove that although unsuccessful, the process towards compiling this historiographical text of 1956 was not monolithic. It represents an early, perhaps last stage between attempts to have a more complete picture of the history of Albanian literature, shortly before ideological purges and the exclusion of other aesthetics, different and opposite from that of Socialist Realism.